

NJOFTIM
Nr. 20802/1, datë 10.11.2022

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM
TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
TË KONFISKUARA**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, kreu V, pika 6, shpallet për shitje me çmim 50% më të ulët se çmimi fillestar i ulur me 30%, si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vend-ndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesor e	Asete			Data	Ora	Vendi
1	Asete të shoqërisë “Citadela” sh.p.k.	Fier	9 583 980	0	9 583 980			30.11.2022	11:30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimin të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të kenë tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.